



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 132/ 2011**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Nafiye Gaş në cilësinë kandidates për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Partia e Drejtësisë (PD) në koalicion me subjektin politik Aleanca Kosova e Re (AKR), për shkak të manipulimit të votave gjatë procesit të numërimit, në seancën e panelit të mbajtur me 02.02.2011, mori këtë:

## **V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Nafiye Gaş në cilësinë kandidates për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Partia e Drejtësisë (PD) në koalicion me subjektin politik Aleanca Kosova e Re (AKR).

## **A r s y e t i m**

PZAP ka pranuar një ankesë me datë 31.01.2011, nga Nafiye Gaş në cilësinë kandidates për deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Partia e Drejtësisë (PD) në koalicion me subjektin politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me të cilën pretendon se nuk është evidentuar numri i votave të cilat i ka poseduar në komunën e Drenasit, Mitrovicës dhe Gjilanit. Parashtruesja e ankesës më tej thekson se në fshatrat: Orllat, Llapushnik, Negrovc dhe Terstenik i mungojnë votat të cilat i ka marrë prej simpatizanteve të subjektit politik PD. Parashtruesja e ankesës potencon se ka tentuar të marrë informata nëpërmjet telefonit tek zyrtarët përgjegjës në Drenas dhe në Mitrovicë me qëllim që të kontrolloheshin Formularët për Rezultatet e Kandidatit (FRK), por dicka e tillë nuk është bërë.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**- ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se shkeljet e pretenduara ne ankese janë të pabaza pasi nuk është ofruar asnjë dëshmi për të besuar se ka ndodhur shkelja e tillë. Parashtruesja e ankesës potencon “*se iu janë manipuluar votat e simpatizantëve të subjektit politik PD*”. PZAP-i konstaton se thëniet e theksuara në ankesë janë të pabaza per shkakun se pretendimet e parashtrueses nuk jane argumentuar dhe per me tepër nuk ka asnjë dëshmi qe te mbeshtesi pretendimet e theksuara. Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 132/2011 më datën 02.02.2011

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**

